



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 382/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit për Kosovën e Re (AKR) në Prishtinë, për shkak mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 11.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar.

Koalicionit për Kosovën e Re (AKR), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3400 (tremijë e katërqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Lëvizja Vetëvendosje, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se Koalicioni për Kosovën e Re, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3.1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 09.12.2010, nga Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën theksohet se me 08 dhjetor 2010 në orën 19:20 në Rrugën UÇK në Prishtinë gjatë fushatës zgjedhore nga anëtarët e Koalicionit Kosova e re është bërë mbulimi i posterave të lëvizjes Vetëvendosje me atë të kandidatit të AKR-së Ibrahim Makolli, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3.1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë posteri i kandidatit të AKR-së mbi atë të Lëvizjes Vetëvendosje. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik AKR, më datë 09.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 10.12.2010 gjerë në ora 12:00. PZAP nuk pranoi përgjigje në ankesë nga subjekti politik AKR.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Përgjegjësit e Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve, parashihen në; Nenin 32 paragrafët 3, 4, 5, 6 dhe 7, të LZP-së.

PZAP-i vlerëson se Koalicioni për Kosovën e Re shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi, andaj konsiderohet si recidivist e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar me gjobë. PZAP-i vlerëson se subjekti politik AKR shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi andaj konsiderohet si recidivist e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar me gjobë. Prandaj nga arsyet e lartcekura, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrasa

A nr. 382/2010 më datën 11.12.2010

